

URDHËR
Nr. 62, datë 19.3.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimet publike”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2008, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe “Rregullores së brendshme të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, miratuar me urdhrin e Komisionerit nr. 46, datë 16.2.2024 (në vijim “Rregullore e brendshme”)

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, znj. Blerta Nerguti, sekretar i përgjithshëm, për kryerjen e funksioneve të mëposhtme:

- a) Nëpunës Autorizues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) titullarit të entit kontraktor në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik;
- c) titullarit të Autoritetit Publik në zbatim të dispozitave ligjore për të drejtën e informimit;
- ç) nënshkrimin e të gjitha akteve me karakter administrativ.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, drejtorëve të përgjithshëm, si vijon:

- a) drejtori i përgjithshëm për të Drejtën e Informimit, nënshkruan akte që lidhen me administrimin, shqyrtimin dhe procesin e hetimit administrativ, sipas legjislacionit për të drejtën e informimit;
- b) drejtori i përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nënshkruan aktet që lidhen me administrimin, shqyrtimin dhe procesin e hetimit administrativ, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët e përgjithshëm pranë zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER
Besnik Dervishi